



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri:** KSC-BC-2020-07  
**Prokurori k. Hysni Gucatit dhe Nasim Haradinajt**

**Vendosi:** Gjykatësi i Procedurës Paraprake  
Gjykatës Nikola Giju

**Administratore:** Dr. Fidelma Donlon

**Data:** 11 nëntor 2020

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Konfidenciale

---

**Urdhër për parashtrime mbi procedurën e rishikimit të Aktakuzës**

---

**Prokurori i Specializuar**  
Xhek Smith

**Mbrojtësit për Hysni Gucatin**  
Xhonatan Elistan Ris  
Hju Bouden

**Mbrojtësit kujdestar për Nasim  
Haradinajn**  
Bastian Martens

**GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE**,<sup>1</sup> në përputhje me nenet 41 dhe 39(2) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 57 dhe 86 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon urdhrin e mëposhtëm.

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 24 shtator 2020, Gjykatësi i Vetëm lëshoi sipas kërkesës,<sup>2</sup> fletarrestimet kundër Hysni Gucati (“z. Gucati”) dhe Nasim Haradinajt (“z. Haradinaj”) (bashkërisht, “të dyshuarit”), si dhe urdhrat për transferimin e tyre në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara në Hagë, Holandë (“objekti i paraburgimit i DHS-së”).<sup>3</sup>
2. Më 25 shtator 2020, të dyshuarit u arrestuan në Kosovë.<sup>4</sup> Z. Gucati dhe z. Haradinaj u transferuan në objektin e paraburgimit të DHS-së përkatësisht më 25 dhe 26 shtator 2020.<sup>5</sup>

---

<sup>1</sup> KSC-BC-2020-07, F00061, Kryetarja, Vendim për caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake, 29 tetor 2020, konfidencial dhe *ex parte*. Para këtij vendimi, Kryetarja kishte caktuar të njëjtin gjykatës si Gjykatës të Vetëm; *Shih* KSC-BC-2020-07, F00003, Kryetarja, *Vendim për caktimin e Gjykatësit të Vetëm në përputhje me nenin 33(2) të Ligjit*, 29 maj 2018, publik.

<sup>2</sup> KSC-BC-2020-07, F00009, Prokurori i Specializuar, *Kërkesë urgjente për fletarrestime dhe urdhra lidhur me to*, 22 shtator 2020, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni publik i redaktuar dhe versioni konfidencial i redaktuar të kësaj kërkesë u protokolluan më 1 tetor 2020

<sup>3</sup> KSC-BC-2020-07, F00012/A01/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni publik i redaktuar i fletarrestimit për Hysni Gucatin*, 24 shtator 2020, publik; KSC-BC-2020-07, F00012/A03/COR/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni publik i redaktuar i fletarrestimit për Nasim Haradinajn*, 24 shtator 2020, publik; KSC-BC-2020-07, F00012/A02/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni publik i redaktuar i urdhrat për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, publik; KSC-BC-2020-07, F00012/A04/RED, Gjykatësi i Vetëm, *Versioni publik i redaktuar i urdhrat për transferim në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 24 shtator 2020, publik.

<sup>4</sup> KSC-BC-2020-07, F00015, Administratorja, *Njoftimi i arrestimit sipas rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020, publik; KSC-BC-2020-07, F00016, Administratorja, *Njoftimi i arrestimit sipas rregullës 55(4)*, 25 shtator 2020, publik.

<sup>5</sup> KSC-BC-2020-07, F00018, Administratorja, *Njoftim për pranimin e Hysni Gucati në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 25 shtator 2020, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale; KSC-BC-2020-07, F00020, Administratorja, *Njoftim për pranimin e Nasim Haradinaj në objektin e paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 26 shtator 2020, publik, me shtojcën 1, konfidenciale.

3. Më 29 shtator dhe 1 tetor 2020, z. HARADINAJ dhe z. GUCATI bënë paraqitjet e para përkatëse (bashkërisht, "paraqitjet e para"), gjatë të cilave u informuan për arsyet e arrestimit.<sup>6</sup> Gjatë paraqitjes së parë të z. Haradinaj, Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") bëri të ditur se priste që të paraqiste aktakuzën kundër të dyshuarve brenda 30 ditësh.<sup>7</sup>

4. Më 27 tetor 2020, Gjykatësi i Vetëm lëshoi "Vendimin në lidhje kundërshtimet e Mbrojtjes".<sup>8</sup> Të njëjtën ditë, ai lëshoi "Vendimin në lidhje me kërkesën për lirimin e menjëhershëm të Nasim Haradinajt" dhe "Vendimin në lidhje me kërkesën për dorëzani", ku i hidhte poshtë kundërshtimet e Mbrojtjes për vazhdimin e paraburgimit të të dyshuarve.<sup>9</sup>

5. Më 30 tetor 2020, ZPS-ja paraqiti aktakuzën rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* kundër të Dyshuarve ("Aktakuza"), duke kërkuar konfirmimin e saj nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.<sup>10</sup>

## II. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

6. Në përputhje me nenin 38(4) të Ligjit, pas përcaktimit se ekziston dyshimi i bazuar mirë se një person është përgjegjës penalisht për vepër penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, ZPS-ja paraqet aktakuzë së bashku me materialin

---

<sup>6</sup> KSC-BC-2020-07, Transkript, 29 shtator 2020, publik; KSC-BC-2020-07, Transkript, 1 tetor 2020, publik.

<sup>7</sup> KSC-BC-2020-07, Transkript, 1 tetor 2020, publik, f. 15. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-07, Transkript, 29 shtator 2020, publik, f. 12-13.

<sup>8</sup> KSC-BC-2020-07, F00057, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim në lidhje me kundërshtimet e Mbrojtjes*, 27 tetor 2020, publik.

<sup>9</sup> KSC-BC-2020-07, F00058, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim në lidhje me kërkesën për lirim të menjëhershëm të Nasim Haradinajt*, 27 tetor 2020, publik, para. 33; KSC-BC-2020-07, F00059, Gjykatësi i Vetëm, *Vendim në lidhje me kërkesën për dorëzani*, 27 tetor 2020, publik, para. 25.

<sup>10</sup> KSC-BC-2020-07, F00063, Prokurori i Specializuar, Parashtrimi i Aktakuzës për konfirmim dhe kërkesat lidhur me të, 30 tetor 2020, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me shtojcat 1-3, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

mbështetës. Në përputhje me rregullën 86(2) të Rregullores, aktakuza klasifikohet konfidenciale dhe *ex parte* kur paraqitet para Gjykatësit të Procedurës Paraprake.

7. Në përputhje me nenin 39(2) të Ligjit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e rishikon aktakuzën dhe materialin mbështetës për të përcaktuar se a është i bindur se ZPS-ja e ka vërtetuar dyshimin e bazuar mirë dhe mbi këtë bazë nëse duhet ta konfirmojë aktakuzën.

8. Në përputhje me rregullën 57(2) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e rishikon vendimin për paraburgim pasi të kenë kaluar dy muaj nga vendimi i fundit për paraburgim.

### III. DISKUTIM

9. Kur aktakuza paraqitet para arrestimit dhe paraburgimit të të dyshuarit, Mbrojtjes i lejohet qasje në aktakuzë dhe materialin mbështetës sipas rregullës 102(1)(a) të Rregullores vetëm pas konfirmimit të saj nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

10. Sidoqoftë, në çështjen konkrete, të dyshuarit kundër të cilëve është paraqitur Aktakuza tashmë janë arrestuar dhe vazhdojnë të mbahen në paraburgim. Megjithëse kundër tyre janë lëshuar fletarrestime, ata nuk i dinë akuzat konkrete kundër tyre të cilat paraqiten në Aktakuzë. Ata tashmë janë informuar për synimin e ZPS-së që të paraqesë aktakuzë kundër tyre deri në fund të tetorit 2020, megjithëse Aktakuza konkrete është paraqitur *ex parte*, në përputhje me rregullën 86(2) të Rregullores. Më e rëndësishme, të dyshuarit kanë të drejtë të kenë të gjithë informacionin e domosdoshëm për të qenë të gjendje të sigurojnë rishikim efektiv të paraburgimit të tyre.

11. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i prirë që, në rrethanat e konkrete të kësaj çështjeje, ta bëjë Aktakuzën të disponueshme për të dyshuarit, me redaktimet e nevojshme. Më tej, nëse dëshirojnë, për hir të drejtësisë ata mund të bëjnë

gjithashtu parashtrime në lidhje me Aktakuzën gjatë rishikimit të saj nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake. Kjo nuk e paragjykon ushtrimin e të drejtave nga të dyshuarit sipas Ligjit dhe Rregullores. Nxjerrja e materialit mbështetës dhe miratimi i masave mbrojtëse në lidhje me të do të bëhet në pajtim me kornizën përkatëse.

12. Para se të marrë vendim për këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake do të përfitonte nga paraqitja e parashtrimeve prej palëve në këtë çështje deri të martën, 17 nëntor 2020.

#### IV. VENDIM

13. Për arsyet e përmendura më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake:

- a) **URDHËRON** palët që të paraqesin parashtrime me shkrim, deri të martën, 17 nëntor 2020, mbi mundësinë që Aktakuza t'i bëhet e disponueshme Mbrojtjes me redaktimet e nevojshme dhe mundësinë që të lejohet Mbrojtja, nëse dëshiron, të bëjë parashtrime në lidhje me Aktakuzën gjatë rishikimit të saj nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.

/nënshkrimi/

**Gjykatës Nikola Giju**  
**Gjykatësi i Procedurës Paraprake**

E mërkurë, 11 nëntor 2020  
Në Hagë, Holandë.